



**BULETINI PERIODIK I
PRAKTIKËS GJYQËSORE
PERIODIČNI BILTEN
SUĐSKE PRAKSE**



REPUBLIKA E KOSOVËS – REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA KUSHTETUESE
USTAVNI SUD
CONSTITUTIONAL COURT**

**JANAR - MARS
JANUAR - MART
2024**

I

**Buletini periodik i praktikës gjyqësore
të Gjykatës Kushtetuese**
(Janar - Mars 2024)

Buletini periodik i praktikës gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese përmban përmbledhjen e aktgjykimeve dhe aktvendimeve me rëndësi dhe interes të veçantë, të cilat janë publikuar nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) gjatë periudhës së fundit tre (3) mujore.

Me qëllimin për ta bërë sa më të qartë për lexuesit natyrën e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, aktgjykimet dhe aktvendimet janë klasifikuar sipas pretendimeve të bazuara në nenet specifike të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Buletini periodik i praktikës gjyqësore është një dokument që publikohet në baza periodike dhe është përgatitur nga Sekretaria e Gjykatës vetëm për çështje informative.

Tekstet e plota të aktgjykimeve dhe të aktvendimeve të përfshira në këtë Buletin janë publikuar në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe mund t'i gjeni të publikuara edhe në ueb-faqen e Gjykatës Kushtetuese: www.gjk-ks.org

Për të pranuar Buletinin periodik të praktikës gjyqësore në postën tuaj elektronike, ju lutemi të regjistrohemi në ueb-faqen e Gjykatës:

www.gjk-s.org/publication_category/buletini-periodik

Vërejtje: Kushdo që dëshiron të kopjojë, përkthejë apo shfrytëzojë për qëllime të tjera të gjitha ose një pjesë të informacioneve të përmbajtura në Buletin, duhet të kontaktojë Sekretarinë e Gjykatës Kushtetuese për udhëzime të mëtejshme.

**Periodični bilten sudske
prakse Ustavnog suda**
(Januar – Mart 2024. godine)

Periodični bilten sudske prakse Ustavnog suda sadrži sažetke presuda i rešenja od posebnog značaja i interesa, koje je Ustavni sud Republike Kosovo (u daljem tekstu: Sud) objavio u poslednja tri (3) meseca.

Kako bi se čitaocima učinila što jasnijom priroda odluka Ustavnog suda, presude i rešenja su klasifikovani prema navodima zasnovanim na određenim članovima Ustava Republike Kosovo (u daljem tekstu: Ustav).

Periodični bilten sudske prakse je dokument koji se objavljuje periodično, a Sekretarijat suda ga priprema samo u informativne svrhe.

Kompletni tekstovi presuda i rešenja sadržanih u ovom Biltenu objavljeni su u Službenom listu Republike Kosovo, a mogu se naći i na internet stranici Ustavnog suda:

www.gjk-ks.org

Da biste primali Periodični bilten sudske prakse na svoju adresu elektronske pošte, molimo vas registrujte se na internet stranici Suda:

https://gjk-ks.org/sr/publication_category/periodicni-bilten/

Napomena: Svako ko želi da kopira, prevede ili za druge svrhe koristi sve ili deo informacija sadržanih u ovom Biltenu treba da kontaktira Sekretarijat Ustavnog suda za dalja uputstva.

"Perandori Justinian" nr. 44, 10 000 Prishtinë
Tel: +383 (0) 38 60 61 62
Mob: +383(0) 45 200 595; +383(0) 45 200 576
Fax: +383(0) 38 60 61 70
Email: gjkata.kushtetuese@gjk-ks.org
©Gjykata Kushtetuese 2024

Tabela e përmbajtjes/Pregled sadržaja

I - Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], Neni 7 [Vlerat], Neni 3 dhe Neni 24 [Barazia para Ligjit], Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

I - Član 4. [Oblik vladanja i podela vlasti], član 7. [Vrednosti], član 3 i član 24. [Jednakost pred zakonom], član 46. [Zaštita imovine]

(i) Ligji nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik

(i) Zakon br. 08/L-196 o platama u javnom sektoru

- Kategorizimi i funksionarëve dhe punonjësve publikë në pozita, grupe, klasa dhe koeficient nga Ligji i kontestuar, ka rezultuar në zbritje substanciale të pagave për kategori përkatëse në sektorin publik, e cila përkundër që është përcaktuar me ligj dhe kishte një qëllim legjitim, nuk ishte proporcionale; përjashtimi i një kategorie të nëpunësve/funksionarëve në sektorin publik nga shtesa tranzitore, përkundër uljes së pagave, është në kundërshtim me parimet e barazisë para ligjit: - shkelje e të drejtave kushtetuese
- Kategorizacija javnih službenika i zaposlenih po pozicijama, grupama, klasama i koeficijentima po osporenom zakonu rezultirala je značajnim smanjenjem plata za relevantnu kategoriju u javnom sektoru, koja, iako je zakonom definisana i ima legitimu svrhu, nije bila proporcionalna; isključenje kategorije državnih službenika/funkcionera u javnom sektoru iz prelaznog dodatka, uprkos smanjenju plate, u suprotnosti je sa načelom jednakosti pred zakonom: -povreda ustavnih prava

KO79/23, Parashtrues: Avokati i Popullit, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Ligjit nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik.....7

KO79/23, podnosilac zahteva: Ombudsman, Ocena ustavnosti Zakona br. 08/L-196 o platama u javnom sektoru.....7

II - Kapitulli II [Të Drejtat dhe Liritë Themelore]

II - Poglavlje II [Prava i osnovne slobode]

- Amendamentet e propozuara kushtetuese nr.27 dhe nr.28, përmes të cilave propozohet plotësimi i kriterit kushtetues për shkarkimin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për shkak të “mosrespektim të rëndë të detyrave”, i përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 104 [Emërimi dhe Shkarkimi i Gjyqtarëve] dhe paragrafin 6 të nenit 109 [Prokurori i Shtetit] të Kushtetutës, me formulimin “ka integritet të cenueshëm”, pakësojnë të drejtat dhe liritë themelore të garantuara me Kapitullin II të Kushtetutës : - shkelje e të drejtave kushtetuese
- Predloženi ustavni amandmani br. 27 i br. 28, kojim se predlaže ispunjenje ustavnog kriteri-juma za razrešenje sudija i tužilaca zbog „neispunjavanja svojih dužnosti.“, definisanog u stavu 4. člana 104. [Imenovanje i razrešenje sudija] i stavu 6 člana 109. [Državno tužilaštvo] Ustava, uz formulaciju „ima ranjiv integritet“, umanjuju osnovna prava i slobode zaga-rantovane Poglavljem II Ustava: - povreda ustavnih prava

KO55/23, Parashtrues: Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Vlerësimi i amendamenteve të propozuara kushtetuese, të referuara nga Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës më 2 mars 2023, përmes shkresës nr. 08/3509/Do/1493/1.....24

KO55/23, podnosilac zahteva: Predsednik Skupštine Republike Kosovo, Ocena predloženih ustavnih amandmana, upućenih od strane predsednika Skupštine Republike Kosovo 2. marta 2023. godine, dopisom br. 08/3509/Do/1493/1.....24

VII - Neni 24 [Barazia para Ligjit]

VII - Član 24. [Jednakost pred zakonom]

(i) *Në lidhje me diskriminimin*

(i) *U pogledu diskriminacije*

- Në rastet kur anëtarja e Kuvendit Komunal jep dorëheqje dhe zëvendësohet me kandidaten tjetër të së njëjtës gjini, edhe kur ajo mund të ketë më pak vota se kandidati nga gjinia tjetër, nuk përbën diskriminim dhe shkelje të barazisë para ligjit për sa kohë që: një përcaktim i tillë parashihet nga ligji; i shërben një qëllimi legjitim – siç është mbrojtja dhe përfaqësimi i grupeve të nën përfaqësuar përmes kuotës gjinore dhe mënjanimi i pabarazive faktike ndërmjet burrave dhe grave; dhe është proporcional – në rastet kur nuk është arritur kuota gjinore prej 30 përqind e përfaqësimit të grave në nivel të subjektit politik, e përcaktuar nga ligji: - mos shkelje e të drejtave kushtetuese
- U slučajevima kada odbornik Skupštine opštine podnese ostavku i bude zamenjen drugim kandidatom istog pola, čak i kada može imati manje glasova od kandidata drugog pola, to ne predstavlja diskriminaciju i povredu jednakosti pred zakonom, sve dok je: takvo određenje propisano zakonom; služi legitimnoj svrsi – kao što je zaštita i predstavljanje nedovoljno zastupljenih grupa kroz rodne kvote i eliminisanje faktičkih nejednakosti između muškaraca i žena; proporcionalno je – u slučajevima kada nije dostignuta zakonski definisana rodna kvota od 30 odsto zastupljenosti žena na nivou političkog subjekta: – nema povrede ustavnih prava

KI195/22, Parashtrues: Besim Morina, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [AA.nr. 11/2022], i 25 gushtit 2022.....36

KI195/22, podnosilac zahteva: Besim Morina, Ocena ustavnosti presude [AA. br. 11/ 2022] Vrhovnog suda Republike Kosovo od 25. avgusta 2022. godine.....36

III - Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

III - Član 31. [Pravo na pravično i nepristrasno suđenje]

(i) *E drejta për vendim të arsyetuar*

(i) *Pravo na obrazloženu odluku*

- Dështimi i Gjykatës Supreme për të dhënë përgjigje specifike në lidhje me pretendimin kryesor të parashtruesit të kërkesës – se ka qenë i diskriminuar në pagë gjatë periudhës kohore korrik 2011 – 30 prill 2015, në raport me kolegët e tij aktorë, përbën shkelje të së drejtës për arsyetim të vendimit gjyqësor, si një nga parakushtet e një vendimi të drejtë: - shkelje e të drejtave kushtetuese
- Propust Vrhovnog suda da da konkretne odgovore u vezi sa glavnom tvrdnjom podnosioca zahteva – da je bio diskriminisan u pogledu plate u periodu od jula 2011. do 30. aprila 2015. godine, u odnosu na svoje kolege glumce, predstavlja povredu prava na obrazloženje sudske odluke, kao jedan od uslova pravične odluke: -*povreda ustavnih prava*

KI137/23, Parashtrues: Naim Berisha, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të [Rev. nr. 451/2022] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 23 nëntorit 2022....39

KI137/23, podnosilac zaheva: Naim Berisha, Ocena ustavnosti presude [Rev. br. 451/2022] Vrhovnog suda Republike Kosovo od 23. novembra 2022. godine.....39

(ii) E drejta për “qasje në gjykatë”

(ii) Pravo na “pristup sudu”

- Refuzimi i Gjykatës Supreme për trajtimin e meritave të revizionit të parashtruesve të kërkesës dhe hedhja poshtë e revizionit si i palejuar për shkak të vlerës së kontestit – si rezultat i interpretimit të gabuar të ligjit në lidhje me mënyrën e precizimit të vlerës së kontestit të kërkesëpadisë, përbën shkelje të së drejtës për “qasje në gjykatë dhe drejtësi”, si pjesë e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm: - shkelje e të drejtave kushtetuese
- Odbijanje Vrhovnog suda da razmatra meritum revizije podnosilaca zahteva i odbijanje revizije, kao nedozvoljena, zbog vrednosti spora – kao rezultat pogrešnog tumačenja zakona u vezi sa načinom preciziranja vrednosti spora tužbenog zahteva, predstavlja povredu prava na “pristup sudu i pravdi”, kao deo pravičnog i nepristrasnog suđenja: - povreda ustavnih prava.

KI186/22, Parashtrues: Malush, Sejdi, Hysni, Skender, Enver, Sherif, Mehdi, Xhevat, Qemajl dhe Jakup Berisha, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit [Rev. nr. 550/2021] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 6 qershorit 2022.....41

KI186/22, podnosilac zahteva: Malush, Sejdi, Hysni, Skender, Enver, Sherif, Mehdi, Xhevat, Qemajl i Jakup Berisha, Ocena ustavnosti rešenja [Rev. br. 550/2021] Vrhovnog suda Republike Kosovo od 6. juna 2022. godine.....41

(iii) E drejta për vendim të arsyetuar

(iii) Pravo na obrazloženu odluku

- Mosarsyetimi i Gjykatës Supreme në lidhje me pretendimet kryesore të parashtruesit të kërkesës, përkatësisht: (i) ligjshmërinë e përbërjes së Panelit Hetimor, në rastet e procedurave disiplinore ndaj prokurorëve; (ii) suspendimin e procedurës disiplinore; dhe (iii) vendosjen e rastit nga Paneli hetimor jashtë afatit ligjor, përbën shkelje të së drejtës për arsyetim të vendimit gjyqësor: - shkelje e të drejtave kushtetuese
- Neobrazloženje Vrhovnog suda u vezi sa glavnim navodima podnosioca zahteva, odnosno: (i) zakonitošću sastava Istražnog veća u slučajevima disciplinskog postupka protiv tužilaca; (ii) obustavom disciplinskog postupka; i (iii) odlučivanjem slučaja od strane Istražnog veća van zakonskog roka, predstavlja povredu prava na obrazloženu sudsku odluku: - povreda ustavnih prava

KI43/23, Parashtrues Armend Hamiti, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [AA. nr. 37/22] të 18 janarit 2023, të Gjykatës Supreme të Kosovës.....43

KI43/23, Podnosilac Armend Hamiti, Ocena ustavnosti Presude Vrhovnog Suda Kosova [AA. br. 37/22] od 18. januara 2023. godine43

(iv) Përkitazi me interpretimin e gabuar të ligjit dhe vendimin e arsyetuar

(iv) Što se tiče pogrešnog tumačenja zakona i obrazložnja odluke

- Konstatimi i gjykatave të rregullta se, vendimi i Zyrës së Rregullatorit të Energjisë për t'ia faturuar qytetarëve të Republikës së Kosovës koston e rrymës së humbur në sistemin e transicionit dhe shpërndarjes – si rezultat i mos pagesës së faturave të energjisë elektrike nga katër (4) komunat veriore të Kosovës - është diskriminues dhe shkel parimin e barazisë para ligjit, si dhe është në përputhje me të drejtën për arsyetim të vendimit dhe nuk përbën vendim arbitrar apo qartazi të paarsyeshëm: - mos shkelje të drejtave kushtetuese
- Zaključak redovnih sudova da je odluka Regulatornog ureda za energiju da naplati građanima Republike Kosovo iznos izgubljene električne energije u sistemu prenosa i raspodele – kao rezultat neplaćanja računa za električnu energiju od strane 4 (četiri) opštine na severu Kosova-predstavlja diskriminaciju i krši načelo jednakosti pred zakonom i u skladu

je sa pravom na obrazloženu odluku i ne predstavlja proizvoljnu ili neobrazloženu odluku:-
nema povrede ustavnih prava

KI103/23, Parashtrues: Zyra e Rregullatorit për Energji e Republikës së Kosovës, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit [Arj.nr.116/2022] të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës, të 9 marsit 202346

KI103/23, podnosilac zahteva: Regulatorni ured za energiju Republike Kosovo, Ocena ustavnosti presude [Arj. br. 116/2022] Vrhovnog suda Republike Kosovo od 9. marta 2023. godine.....46

(v) E drejta për vendim të arsyetuar

(v) Pravo na obrazloženu odluku

- Mosarsyetimi i vendimit nga Kolegji i Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme në lidhje me pretendimet kryesore të parashtruesve të kërkesës, përkatësisht refuzimit të caktimit të propozimit të masës së sigurisë dhe legjitimitetit procedural të AKP-së, përbën shkelje të së drejtës për arsyetim të vendimit, si pjesë e gjykimit të drejtë dhe të paanshëm: - shkelje e të drejtave kushtetuese
- Neobrazložnje odluke od strane Žalbenog veća Posebne komore Vrhovnog suda u vezi sa glavnim navodima podnosilaca zahteva, odnosno odbijanje određivanja predloga mere bezbednosti i proceduralnog legaliteta KAP-a, predstavlja povredu prava na obrazloženu odluku, kao deo pravičnog i nepristrasnog suđenja:-*povreda ustavnih prava*

KI168/22, Parashtrues: Nusret Kabashi, Bajram Kabashi dhe Driton Kabashi, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Apelit të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [AC-I.-22-0418-A0001], të 22 shtatorit 2022.....49

KI168/22, podnosilac zahteva: Nusret Kabashi, Bajram Kabashi i Driton Kabashi, Ocena ustavnosti rešenja Žalbenog veća Posebne komore Vrhovnog suda Republike Kosovo [AC-I.-22-0418-A0001] od 22. septembra 2022. godine.....49

(vi) E drejta për vendim të arsyetuar

(vi) Pravo na obrazloženu odluku

- Mosarsyetimi i vendimit të Gjykatës Supreme në lidhje me aplikueshmërinë e gabuar të ligjeve nga gjykatat e shkallëve më të ulëta dhe për statusin e Instruksionit Administrativ si akt nënligjor; jokonsistenca e Gjykatës Supreme, si dhe ndryshimi i praktikës së saj gjyqësore pa një arsye legjitime, përbën shkelje të së drejtës për arsyetim të vendimit gjyqësor: - shkelje e të drejtave kushtetuese
- Neobrazložnje odluke Vrhovnog suda u vezi sa pogrešnom primenom zakona od strane nižestepenih sudova i statusom Administrativnog upustva kao podzakonskog akta; nedoslednost Vrhovnog suda, kao i promena svoje sudske prakse bez pravnog osnova, predstavlja povredu prava na obrazloženu sudsku odluku:-*povreda ustavnih prava*

KI178/22, Parashtrues: Ibrahim Tërnavë, Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës [Rev. nr. 59/2021], të 6 majit 2022.....52

KI178/22, podnosilac zahteva: Ibrahim Tërnavë, Ocena ustavnosti presude Vrhovnog suda Republike Kosovo [Rev. nr. 59/2021] od 6. maja 2022. godine.....52

Neni 4 [Forma e Qeverisjes dhe Ndarja e Pushtetit], Neni 7 [Vlerat], Neni 3 dhe Neni 24 [Barazia para Ligjit], Neni 46 [Mbrojtja e Pronës]

KO79/23, parashtrues: Avokati i Popullit, Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit nr. 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik

Kategorizimi i funksionarëve dhe punonjësve publikë në pozita, grupe, klasa dhe koeficient nga Ligji i kontestuar, ka rezultuar në zbritje substanciale të pagave për kategori përkatëse në sektorin publik, e cila përkundër që është përcaktuar me ligj dhe kishte një qëllim legjitim, nuk ishte proporcionale; përjashtimi i një kategorie të nëpunësve/funksionarëve në sektorin publik nga shtesa tranzitore përkundër uljes së pagave, është në kundërshtim me parimet e barazisë para ligjit:

- shkelje e të drejtave kushtetuese.

Faktet

Aktgjykimi fillimisht sqaron që Ligji i kontestuar është publikuar në Gazetën Zyrtare më 5 janar 2023, ndërsa ka hyrë në fuqi më 5 shkurt 2023. I njëjti është miratuar pasi ligji paraprak, përkatësisht Ligji Nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik, pas kërkesës së Avokatit të Popullit, ishte shpallur në kundërshtim me Kushtetutën përmes Aktgjykimit të Gjykatës KO219/19. Aktgjykimi më tej sqaron që, Ligji i kontestuar, me qëllim të krijimit të një “sistemi të njëtrajtshëm të pagave në sektorin publik”, shfuqizon (i) Ligjin nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë; (ii) dispozita të caktuara të ligjeve të veçanta ndërlidhur me institucione dhe agjenci të pavarura; si dhe (iii) çdo ligj dhe akt tjetër nënligjor që është në kundërshtim me përcaktimet e tij. Sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, i njëjti, përmes Shtojcave përkatëse, kategorizon të gjithë funksionarët/zyrtarët dhe nëpunësit publikë që bien në fushëveprimin e Ligjit të kontestuar, në pozita, grupe, klasa dhe koeficientë. Efekti i këtij kategorizimi në ndërlidhje me vlerën e koeficientit të përcaktuar përmes Ligjit Nr.08/L-213 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.08/L-193 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për Vitin 2023, ka rezultuar në ngritje substanciale të nivelit të pagave të një pjese të zyrtarëve të sektorit publik dhe zbritje substanciale të nivelit të pagave të një pjese tjetër. Kategoritë e afektuara nga zbritja e nivelit të

Çlan 4. [Oblik vladanja i podela vlasti], član 7. [Vrednosti], član 3 i član 24. [Jednakost pred zakonom], član 46. [Zaštita imovine]

KO79/23, podnosilac zahteva: Ombudsman, Zahtev za ocenu ustavnosti Zakona br. 08/L-196 o platama u javnom sektoru

Kategorizacija javnih službenika i zaposlenih po pozicijama, grupama, klasama i koeficijentima po osporenom zakonu rezultirala je značajnim smanjenjem plata za relevantnu kategoriju u javnom sektoru, koja, iako je zakonom definisana i ima legitimnu svrhu, nije bila proporcionalna; isključenje kategorije državnih službenika/funkcionera u javnom sektoru iz prelaznog dodatka, uprkos smanjenju plate, u suprotnosti je sa načelom jednakosti pred zakonom:

- povreda ustavnih prava.

Činjenice

U presudi se najpre pojašnjava da je osporeni zakon objavljen u Službenom listu 5. januara 2023. godine, a stupio je na snagu 5. februara 2023. godine. Isti je usvojen nakon što je prethodni zakon, odnosno Zakon br. 06/L-111 o platama u javnom sektoru, po zahtevu Ombudsmana, bio proglašen suprotnim Ustavu, presudom Suda KO219/19. U presudi se dalje pojašnjava da osporeni Zakon, sa ciljem uspostavljanja „jedinstvenog platnog sistema u javnom sektoru“, stavlja van snage (i) Zakon br. 03/L-147 o platama javnih službenika; (ii) određene odredbe posebnih zakona u vezi sa nezavisnim institucijama i agencijama; i (iii) svaki drugi zakon i podzakonski akt koji je u suprotnosti sa njegovim odredbama. Prema pojašnjenjima datim u presudi, isti, kroz relevantne priloge, kategoriše sve javne funkcionere/službenike i zaposlene, koji spadaju pod delokrug osporenog zakona, po pozicijama, grupama, razredima i koeficijentima. Efekat ove kategorizacije u povezanost sa vrednošću koeficijenta utvrđenog Zakonom br. 08/L-213 o izmenama i dopunama Zakona br. 08/L-193 o budžetskim izdvajanjima za budžet Republike Kosovo za 2023. godinu, rezultirao je suštinskim povećanjem nivoa plata jednog dela službenika javnog sektora i suštinskim smanjenjem nivoa plata jednog drugog dela. Kategorije koje su pogođene smanjenjem nivoa plata, imaju koristi od prelaznog perioda od dve (2) godine nakon stupanja na snagu zakona,

pagave, përfitojnë nga një periudhë tranzitore dy (2) vjeçare pas hyrjes në fuqi të ligjit, përkatësisht (i) gjatë vitit të parë, njëqind përqind (100%) të shtesës tranzitore dhe rrjedhimisht, përgjatë këtij viti nuk afektohen nga zbritja e nivelit të pagës; ndërsa, (ii) gjatë vitit të dytë, pesëdhjetë përqind (50%) të shtesës tranzitore. Aktgjykimi gjithashtu sqaron që, nga të drejtat e periudhës tranzitore janë përjashtuar (i) anëtarët e shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës, të cilët për pasojë janë afektuar me zbritje të menjëhershme pagash përmes hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar; dhe (ii) të gjithë personat që janë punësuar në sektorin publik pas hyrjes së tij në fuqi. Më tej, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, Ligji i kontestuar gjithashtu (i) delegon përcaktimin e vlerës së koeficientit në një ligj tjetër, përkatësisht Ligjin për Ndarjet Buxhetore të Republikës së Kosovës; (ii) saktëson që zbritja e nivelit të pagës në Republikën e Kosovës mund të bëhet vetëm në rast të dy rrethanave përjashtimore, përkatësisht një *“tronditje makroekonomike”* apo shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme; (iii) saktëson rregullat e përcaktimit të kategorive të shtesave dhe kompensimeve, përfshirë tavanet/kufijtë përkatës buxhetor, duke saktësuar gjithashtu që këto çështje rregullohen ekskluzivisht me këtë ligj dhe mund të rregullohen më tej vetëm me akte të tjera nënligjore; dhe (iv) përcakton kompetencën e Ministrisë së Punëve të Brendshme (MPB), për të miratuar, ndër tjerash, çështjet që ndërlidhen me strukturën, komponentët apo nivelet e koeficienteve në institucionet publike të Republikës së Kosovës.

Aktgjykimi gjithashtu sqaron që, Ligji i kontestuar tashmë ka prodhuar efektet e tij tek kategoritë të cilave u është ngritur niveli i pagës, si dhe tek kategoritë që u është zbritur niveli i pagës, e që nuk i janë nënshtruar mbrojtjes përmes periudhës tranzitore, përkatësisht (i) për të gjithë funksionarët/zyrtarët/nëpunësit për pesëmbëdhjetë (15) vitet e para të përvojës së punës, sepse lartësia e shtesës për përvojën e punës është përgjysmuar me hyrjen në fuqi të Ligjit të kontestuar; dhe (ii) shërbimin e jashtëm të Republikës së Kosovës, i cili është përjashtuar nga e drejta në shtesë tranzitore. Me përfundimin e afatit një (1) vjeçar të periudhës/shtesës tranzitore, përkatësisht nga 5 shkurti 2024, me zbritje prej pesëdhjetë përqind (50%) të shtesës

odnosno (i) tokom prve godine, sto posto (100%) prelazni dodatak i shodno tome, tokom ove godine na njih ne utiče smanjenje nivoa plate; dok, (ii) tokom druge godine, pedeset odsto (50%) prelaznog dodatka. Presuda takođe pojašnjava da su iz prava prelaznog perioda isključeni (i) članovi spoljne službe Republike Kosovo, koji su kao posledica bili pogođeni trenutnim smanjenjem plata stupanjem na snagu osporenog zakona; i (ii) sva lica koja su zaposlena u javnom sektoru nakon njegovog stupanja na snagu. Dalje prema pojašnjenjima datim u presudi, osporeni zakon takođe (i) delegira utvrđivanje vrednosti koeficijenta na drugi zakon, odnosno na Zakon o budžetskim izdvajanjima Republike Kosovo; (ii) precizira da se smanjenje nivoa plata u Republici Kosovo može izvršiti samo u slučaju dve izuzetne okolnosti, odnosno „makroekonomskog šoka“ ili proglašenja vanrednog stanja; (iii) precizira pravila za određivanje kategorija dodataka i naknada, uključujući relevantne budžetske plafone/ograničenja, takođe precizirajući da se ova pitanja isključivo regulišu ovim zakonom i da se mogu dalje regulisati samo drugim podzakonskim aktima; i (iv) utvrđuje nadležnost Ministarstva unutrašnjih poslova (MUP), da odobrava, između ostalog, pitanja koja se odnose na strukturu, komponente ili nivoe koeficijenata u javnim institucijama Republike Kosovo.

U presudi se takođe pojašnjava da je osporeni zakon već proizveo svoje efekte na kategorije kojima je nivo plate povećan, kao i na kategorije kojima je nivo plate smanjen i koje nisu bile predmet zaštite kroz prelazni period, odnosno (i) za sve funkcionere/službenike/zaposlene za prvih petnaest (15) godina radnog iskustva, jer je visina dodatka za radno iskustvo prepolovljena stupanjem na snagu osporenog zakona; i (ii) spoljna služba Republike Kosovo, koja je isključena od prava na prelazni dodatak. Završetkom roka od jedne (1) godine prelaznog perioda/dodatka, odnosno od 5. februara 2024. godine, smanjenjem od pedeset odsto (50%) prelaznog dodatka, biće pogođeni svi funkcioneri/službenici/zaposleni koji potpadaju pod delokrug osporenog zakona i kojima je nivo plate smanjen u skladu sa odredbama osporenog zakona.

tranzitore, do të afektohen të gjithë funksionarët/zyrtarët/nëpunësit që hyjnë në fushëveprimin e Ligjit të kontestuar dhe të cilëve u është zbritur niveli i pagës sipas përcaktimeve të Ligjit të kontestuar.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

Avokati i Popullit, duke u mbështetur edhe në njëqind e katër (104) ankesa të dorëzuara pranë Institucionit të tij nga funksionarë/zyrtarë/nëpunës, organizata e asociacione, me pretendime për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore si rezultat i zbritjes së nivelit të pagave në sektorin publik, në esencë, para Gjykatës pretendoi që Ligji i kontestuar është nxjerrë në kundërshtim me (i) të drejtat dhe liritë themelore, përfshirë të drejtën për barazi para ligjit dhe të drejtën për gëzim paqësor të pronës; dhe (ii) ndarjen dhe balancimin e pushteteve në Republikën e Kosovës, në cenim të garancive kushtetuese për pavarësinë e institucioneve të pavarura. Avokati i Popullit, më saktësisht, pretendoi që Ligji i kontestuar është në kundërshtim me parimin e sundimit të ligjit, sigurisë juridike dhe parashikueshmërisë, ndër tjerash, sepse delegon përcaktimin e vlerës së koeficientit në Ligjin për Ndarjet Buxhetore, ligji i cili është miratuar pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar, duke rezultuar në zbritjen selektive dhe arbitrare të nivelit të pagave të një pjese të konsiderueshme të sektorit publik, në kundërshtim me përcaktimet e vet Ligjit të kontestuar, sipas të cilit, zbritja e pagave mund të jetë pasojë vetëm e një tronditjeje makroekonomike ose shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në Republikën e Kosovës. Për më tepër, Avokati i Popullit pretendoi që (i) zbritja joproportionale e nivelit të pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve është në kundërshtim të plotë me Kushtetutën, ligjet e aplikueshme, standardet ndërkombëtare dhe Aktgjykimet e Gjykatës Kushtetuese; (ii) zbritja arbitrare e nivelit të pagave të shërbimit të jashtëm të Republikës së Kosovës, si e vetmja kategori e sektorit publik të cilën Ligji i kontestuar e përjashton nga periudha dy (2) vjeçare tranzitore, është në kundërshtim me parimet e barazisë para ligjit; (iii) të gjithë të punësuarit në sektorin publik pas hyrjes në fuqi të Ligjit të kontestuar, trajtohen në mënyrë të pabarabartë përgjatë periudhës tranzitore, sepse nuk përfitojnë “pagë të njëjtë për punë të njëjtë”, në kundërshtim me vet garancitë e Ligjit të

Žalba podnosioca zahteva

Ombudsman, oslanjajući se i na sto četiri (104) žalbe koje su njegovoj Instituciji podneli funkcioneri/sluzbenici/zaposleni, organizacije i udruženja, sa navodima o povredi osnovnih prava i sloboda usled smanjenja visine plata u javnom sektoru, , u suštini, pred Sudom tvrdi da je osporeni zakon donet uz kršenje (i) osnovnih prava i sloboda, uključujući pravo na jednakost pred zakonom i pravo na mirno uživanje imovine; i (ii) poделе i balansiranje vlasti u Republici Kosovo, kršenjem ustavnih garancija za nezavisnost nezavisnih institucija. Ombudsman tačnije tvrdi da je osporeni zakon u suprotnosti sa principom vladavine prava, pravne sigurnosti i predvidivosti, između ostalog, zato što utvrđivanje vrednosti koeficijenta delegira na Zakon o budžetskim izdvajanjima, zakon koji je usvojen nakon stupanja na snagu osporenog zakona, što je rezultiralo selektivnim i proizvoljnim smanjenjem nivoa plata značajnog dela javnog sektora, suprotno utvrđivanjima samog osporenog zakona, prema kojem, se smanjenje plata može biti posledica samo makroekonomskog šoka ili proglašenja vanrednog stanja u Republici Kosovo. Štaviše, Ombudsman tvrdi da je (i) nesrazmerno smanjenje nivoa plata sudija i tužilaca u potpunosti suprotnosti sa Ustavom, važećim zakonima, međunarodnim standardima i presudama Ustavnog suda; (ii) proizvoljno smanjenje nivoa plata u spoljnoj službi Republike Kosovo, kao jedine kategorije javnog sektora koju sporni zakon isključuje iz dvogodišnjeg prelaznog perioda, je u suprotnosti sa principima jednakosti pred zakonom; (iii) svi zaposleni u javnom sektoru nakon stupanja na snagu osporenog zakona , u prelaznom periodu su nejednako tretirani, jer ne primaju „jednaku platu za jednak rad“ suprotno samim garancijama osporenog zakona; (iv) da je svim javnim funkcionerima/sluzbenicima/zaposlenim koji imaju do petnaest (15) godina radnog iskustva povređeno pravo na mirno uživanje imovine usled smanjenja visine naknade za radno iskustvo, a da se za to nije težilo bilo kakvom legitimnom cilju; (v) narušena je funkcionalna, organizaciona i budžetska nezavisnost sudske vlasti i

kontestuar; (iv) e drejta në gëzim paqësor të pronës të të gjithë funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve publikë deri në pesëmbëdhjetë (15) vite përvojë pune, është cenuar si rezultat i zbritjes së nivelit të shtesës për përvojë pune, pa ndjekur asnjë qëllim legjitim; (v) pavarësia funksionale, organizative dhe buxhetore e pushtetit gjyqësor dhe e institucioneve të pavarura kushtetuese, është cenuar në kundërshtim të plotë me garancitë kushtetuese dhe praktikën gjyqësore të Gjykatës Kushtetuese; dhe (vi) Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese KO219/19, përmes të cilit, Ligji paraprak për Pagat në Sektorin Publik, është shpallur në kundërshtim me Kushtetutën dhe përmes të cilit, janë përcaktuar parimet që duhet të respektohen lidhur me pagat në sektorin publik, nuk është zbatuar nga Qeveria dhe Kuvendi. Më tej, Avokati i Popullit kërkoi nga Gjykata që vlerësimin të kushtetutshmërisë së Ligjit të kontestuar t'i nënshtrohet vetëm pjesa me efekt në zbritje të pagave dhe jo ajo në ndërlidhje me kategorinë që u janë ngritur pagat, sepse të drejtat e këtyre të fundit, nuk janë cenuar përmes Ligjit të kontestuar.

Pretendimet e Avokatit të Popullit u kundërshtuan nga Qeveria, përmes MPB-së. Kjo e fundit, sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, theksoi që, qëllimi i Ligjit të kontestuar është *“harmonizimi i pagave në sektorin publik”* dhe për më tepër, që i njëjti nuk ka prodhuar efektin e zbritjes së nivelit të pagave në sektorin publik. Kjo, sipas Ministrisë, ndër tjerash, sepse (i) vlera e koeficientit nuk është përcaktuar përmes Ligjit të kontestuar, por përmes Ligjit për Ndarjet Buxhetore, i cili nuk është kontestuar para Gjykatës; (ii) Ligji i kontestuar është i parashikueshëm sepse përcakton rrethanat në të cilat zbritja e pagës mund të bëhet në të ardhmen, ndërsa përcakton periudhë tranzicioni dy (2) vjeçare, përgjatë së cilës niveli i pagave të zbritura do të ruhet sipas përshkallëzimit të përcaktuar në të njëjtin; (iii) pavarësia e pushtetit gjyqësor nuk është cenuar sepse pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk janë zbritur, por janë ngritur, duke marrë parasysh që Vendimi [nr.20/14] i Qeverisë i 20 dhjetorit 2017 dhe i cili kishte rezultuar në ngritjen e pagave të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ishte nxjerrë në kundërshtim me ligjin e aplikueshëm dhe për pasojë, i njëjti është shfuqizuar nga Qeveria aktuale përmes Vendimit [nr.03/109], të 23

ustavnih nezavisnih institucija u potpunosti sa ustavnim garancijama i sudskom praksom Ustavnog suda; i (vi) presuda Ustavnog suda KO219/19, kojom je prethodni zakon o platama u javnom sektoru proglašen suprotnim Ustavu i kojom su utvrđeni principi koji moraju da se poštuju u vezi sa platama u javnom sektoru, nije sprovedena od strane Vlade i Skupštine. Dalje, Ombudsman zahteva od Suda da se ocena ustavnosti osporenog zakona podvrgne samo delu koji ima efekat smanjenja plata, a ne i delu u vezi sa kategorijom kojoj su plate povećane, jer prava ovih poslednjih nisu povređena kroz osporeni zakon. Navodima Ombudsmana se protivila Vlada, preko MUP-a. Ovaj poslednje navedeni, prema pojašnjenima datim u presudi, ističe da je svrha osporenog zakona *„usklađivanje plata u javnom sektoru“*, a štaviše, isti nije proizveo efekat smanjenja nivoa plata u javnom sektoru. To, prema Ministarstvu, između ostalog i zato što (i) vrednost koeficijenta nije utvrđena osporenim zakonom, već Zakonom o budžetskim izdvajanjima koji nije osporen pred Sudom; (ii) osporeni zakon je predvidiv, jer određuje okolnosti pod kojima se smanjenje plata može izvršiti u budućnosti, dok utvrđuje prelazni period od dve (2) godine tokom kojeg će se nivo smanjenih plata održavati tokom prve godine prema skaliranju utvrđenom u istom; (iii) nije narušena nezavisnost sudske vlasti jer nisu smanjene plate sudija i tužilaca, već su povećane, imajući u vidu da je odluka [br. 20/14] Vlade od 20. decembra 2017. godine koja je rezultirala povećanjem plata sudijama i tužiocima, doneta u suprotnosti sa važećim zakonom i kao rezultat toga ista je ukinuta od strane sadašnje Vlade odlukom [br. 03/109] od 23. novembra 2022. godine. Štaviše, prema MUP-u i, između ostalog, (i) na osnovu Ustava, Vlada je ta koja predlaže, a Skupština ona koja usvaja budžet Republike Kosovo; (ii) osporeni zakon je u skladu sa podelom i balansiranjem vlasti i ne narušava nezavisnost nezavisnih institucija; i (iii) da je skaliranje vrednosti dodatka radnog iskustva u skladu sa namerom zakonodavca da *„podrži i stimuliše doprinos kao uslugu državi i društvu”*.

nëntorit 2022. Për më tepër, sipas MPB-së dhe ndër tjerash, (i) bazuar në Kushtetutë, është Qeveria ajo që propozon dhe Kuvendi që miraton buxhetin e Republikës së Kosovës; (ii) Ligji i kontestuar është në përputhje me ndarjen dhe balancimin e pushteteve dhe nuk cenon pavarësinë e institucioneve të pavarura; dhe (iii) përshkallëzimi i vlerës së shtesës së përvojës së punës është në përputhje me qëllimin e ligjvënësit për të “mbështetur dhe stimuluar kontributin si shërbim ndaj shtetit dhe shoqërisë”.

Vlerësimi i Gjykatës

Aktgjykimi, ndër tjerash, fillimisht shtjelloi (i) parimet e përgjithshme lidhur me ndarjen dhe ndërveprimin e pushteteve në Republikën e Kosovës, përfshirë pavarësinë e pushtetit gjyqësor, sistemit prokurorial dhe institucioneve të pavarura kushtetuese; (ii) parimet e përgjithshme që burojnë nga praktika gjyqësore relevante e Gjykatës Kushtetuese, me theks në Aktgjykimet që, ndër vite, kanë shtjelluar në mënyrë specifike çështjet që ndërlidhen me pavarësinë funksionale, organizative dhe buxhetore të institucioneve të pavarura kushtetuese, përfshirë në kontekst të organizimit të tyre të brendshëm dhe rregullimit të specifikave lidhur me personelin e tyre; dhe (iii) parimet që janë përcaktuar përmes Aktgjykimit të Gjykatës KO219/19 lidhur me pagat në sektorin publik, përfshirë në kontekst të ndarjes dhe balancimit të pushteteve dhe të drejtave dhe lirive themelore. Për më tepër, Aktgjykimi gjithashtu shtjellon parimet e përgjithshme që burojnë nga praktikat relevante ndërkombëtare, përfshirë (i) Opinionet e Komisionit të Venecias; (ii) praktikën gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ) dhe të Gjykatës së Drejtësisë së Bashkimit Evropian (GJDBE), përmes të cilave janë shqyrtuar pretendimet për shkelje të të drejtave dhe lirive themelore si pasojë e zbritjes së pagave/beneficioneve në sektorin publik; dhe (iii) praktikën gjyqësore të gjykatave tjera kushtetuese në shqyrtimin e ligjeve që ndërlidhen me pagat në sektorin publik, përfshirë por duke mos u kufizuar në Gjykatat Kushtetuese/Supreme të Bosnjë dhe Hercegovinës, Kanadasë, Letonisë, Polonisë, Portugalisë, Qipros, Sllovenisë dhe Republikës së Shqipërisë.

Aktgjykimi gjithashtu rikujton faktin që përmes Aktgjykimit KO219/19, Gjykata, specifikisht, kishte tërhequr vërejtjen që bazuar në parimet

Ocena Suda

Presuda, između ostalog, prvo razrađuje (i) opšta načela koja se odnose na podelu i interakciju vlasti u Republici Kosovo, uključujući nezavisnost sudske vlasti, tužilačkog sistema i ustavnih nezavisnih institucija; (ii) opšta načela koja potiču iz relevantne sudske prakse Ustavnog suda, sa naglaskom, u presudama koje su, tokom godina, posebno razradile pitanja koja se odnose na funkcionalnu, organizacionu i budžetsku nezavisnost ustavnih nezavisnih institucija, uključujući u kontekstu njihove unutrašnje organizacije i uređenja specifičnosti vezanih za njihovo osoblje; i (iii) principe koji su utvrđeni presudom Suda KO219/19 u vezi sa platama u javnom sektoru, uključujući u kontekstu podele i balansiranja vlasti i osnovnih prava i sloboda. Štaviše, presuda takođe razrađuje opšte principe koji proizilaze iz relevantne međunarodne prakse, uključujući (i) mišljenja Venecijanske komisije; (ii) sudsku praksu Evropskog suda za ljudska prava (ESLJP) i Suda pravde Evropske unije (SPEU), kroz koje su razmatrani navodi o kršenju osnovnih prava i sloboda kao rezultat smanjenja plata/beneficija u javnom sektoru; i (iii) sudsku praksu drugih ustavnih sudova u razmatranju zakona koji se odnose na plate u javnom sektoru, uključujući, ali ne ograničavajući se na Ustavne/vrhovne sudove Bosne i Hercegovine, Kanade, Letonije, Poljske, Portugala, Kipra, Slovenije i Republike Albanije. Presuda takođe podseća na činjenicu da je presudom KO219/19 Sud posebno skrenuo pažnju da se na osnovu ustavnih načela, važećih zakona u Republici Kosovo i relevantnih međunarodnih načela (i) plate sudija i tužilaca ne mogu smanjivati za vreme vršenja njihove funkcije, osim ako je dato smanjenje učinjeno srazmerno i u kontekstu zvanično priznatih ekonomskih kriza; (ii) funkcionalna, organizaciona i budžetska nezavisnost ustavnih nezavisnih institucija mora

kushtetuese, ligjet e aplikueshme në Republikën e Kosovës dhe parimet relevante ndërkombëtare (i) pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve nuk mund të zbriten përgjatë ushtrimit të funksionit të tyre, përveç nëse zbritja përkatëse është bërë në mënyrë proporcionale dhe në kontekst të krizave ekonomike të njohura zyrtarisht; (ii) pavarësia funksionale, organizative dhe buxhetore e institucioneve të pavarura kushtetuese duhet të respektohet; (iii) barra e zbritjes së pagave, nëse veç konsiderohet si e domosdoshme për shkak të krizës ekonomike, duhet të jetë proporcionale, ashtu që asnjë sektor i veçantë të mos e marrë përsipër barrën kryesore; dhe (iv) Qeveria, si propozuese e ligjeve dhe Kuvendi, si ligjvënës, gjatë hartimit të legjislacionit që ka të bëjë me pagat në sektorin publik, qoftë përmes një ligji të përgjithshëm ose përmes disa ligjeve të veçanta apo edhe amendamentimin e ligjeve ekzistuese, duhet të kenë parasysh shkallën e parashikueshmërisë, si pjesë e parimit të sigurisë juridike dhe sundimit të ligjit, përfshirë të drejtat kushtetuese për barazinë para ligjit dhe gëzimin paqësor të pronës, të të gjithë personave që mund të preken nga zbritja e mundshme e nivelit të pagave.

Marrë parasysh parimet e lartcekura dhe të shtjelluara detajisht në Aktgjykim dhe ndërlidhjen e pretendimeve dhe dispozitave të kontestuara me njëra tjetrën, vlerësimi i kushtetutshmërisë së Ligjit të lartcekur, në parim, rezulton në konstatime të Gjykatës që ndërlidhen me dy kategori çështjesh, përkatësisht (i) sistemin e pagave dhe shpërblimeve dhe procedurave përkatëse, për aq sa afekton pavarësinë funksionale, organizative dhe buxhetore të institucioneve të pavarura kushtetuese; dhe (ii) të drejtat dhe liritë themelore në raport me zbritjen e nivelit të pagave të funksionarëve/zyrtarëve/nëpunësve publikë.

- *rregullat dhe kushtet për përcaktimin e nivelit të pagave që ndërlidhen me sistemin e drejtësisë dhe institucionet e pavarura kushtetuese*

Aktgjykimi thekson që Ligji i kontestuar, ndër tjerash, saktëson edhe rregullat për përcaktimin e shtesave, kompensimeve dhe ekuivalencave, përfshirë krijimin e funksioneve, pozitave apo emërtesave të reja në institucionet publike. I njëjti, në kontekst të nëpunësve në (i) Presidencën

se postovati; (iii) teret smanjenja zarada, ako se već smatra neophodnim zbog ekonomske krize, treba da bude proporcionalan, tako da nijedan sektor ne preuzme glavni teret; i (iv) da Vlada, kao predlagač zakona i Skupština, kao zakonodavac, prilikom izrade zakonodavstva koje se odnosi na plate u javnom sektoru, bilo opštim zakonom ili nekoliko posebnim zakonima ili pak izmenama i dopunama postojećih zakona, moraju uzeti u obzir stepen predvidljivosti, kao deo načela pravne sigurnosti i vladavine prave, uključujući ustavna prava o jednakosti pred zakonom i o mirnom uživanju imovine svih lica koja mogu biti pogođena mogućim smanjenjem nivoa postojećih plata.

Uzimajući u obzir gore navedena načela koja su detaljno razrađena u presudi i međusobnu povezanost navoda i osporenih odredbi, ocena ustavnosti navedenog Zakona, u principu, rezultira nalazima Suda koji se odnose na dve kategorije pitanja, odnosno (i) na sistem plata i nagrada i odgovarajuće procedure u onoj meri u kojoj utiču na funkcionalnu, organizacionu i budžetsku nezavisnost ustavnih nezavisnih institucija; i (ii) osnovna prava i slobode u vezi sa smanjenjem nivoa plata javnih funkcionera/službenika/zaposlenih.

- *pravila i uslovi za određivanje nivoa plata koji se odnose na pravosudni sistem i na ustavne nezavisne institucije*

U presudi se ističe da se osporenim zakonom, između ostalog, preciziraju i pravila za određivanje dodataka, naknada i ekvivalentnosti, uključujući i stvaranje novih funkcija, položaja ili zvanja u javnim institucijama. Isti, u kontekstu zaposlenih u (i) Predsedništvu Republike Kosovo; (ii) Ustavnom sudu; (iii) Pravosudnom sistemu; (iv) Skupštini Republike Kosovo; i (v) ustavnim nezavisnim institucijama, precizira da se on „*primenjuje u meri u kojoj ne narušava njihova Ustavom zagarantovana funkcionalna i organizaciona nezavisnost*“. Međutim, i pored takve formulacije, u osporenom zakonu je takođe (i) precizirano da su pravila i uslovi za utvrđivanje plate, dodataka i naknada zaposlenih u javnom sektoru isključivo predmet regulisanja ovim zakonom i da se mogu regulisati i drugim podzakonskim aktima, samo kada je izričito predviđeno ovim zakonom; a (ii) stavlja van snage bilo koju odredbu drugog zakona

e Republikës së Kosovës; (ii) Gjykatën Kushtetuese; (iii) Sistemin e Drejtësisë; (iv) Kuvendin e Republikës së Kosovës; dhe (v) institucionet e pavarura kushtetuese, saktëson që *“zbatohet për atë që nuk cenon pavarësinë e tyre funksionale dhe organizative të garantuar me Kushtetutë”*. Megjithatë, përkundër një formulimi të tillë, Ligji i kontestuar gjithashtu (i) specifikon që rregullat dhe kushtet për përcaktimin e pagës, shtesave e kompenzimeve të të punësuarve në sektorin publik, janë ekskluzivisht objekt i rregullimit nga ky ligj dhe mund të rregullohen edhe me akte të tjera nënligjore, vetëm kur parashihet shprehimisht nga ky ligj; ndërsa (ii) shfuqizon çdo dispozitë të ligjit apo aktit tjetër nënligjor, përfshirë dispozitat përkatëse të ligjeve të veçanta të institucioneve të pavarura dhe aktet e tyre nënligjore, që rregullojnë çështjen e pagës, kompenzimeve, shtesave, shpërblimeve apo një kategorie tjetër në fushën e pagave, e që nuk është autorizuar shprehimisht sipas dispozitave të këtij ligji. Rrjedhimisht dhe sipas sqarimeve të dhëna në Aktgjykim, përmbushja e pavarësisë funksionale, organizative dhe të administrimit të pavarur buxhetor të institucioneve të pavarura kushtetuese, është kushtëzuar vetëm në nxjerrjen e akteve nënligjore nën kufizimet specifike të Ligjit të kontestuar. Një qasje e tillë nuk është ndjekur në kontekst të institucioneve të pavarura përmes Ligjit nr.08/L-197 për Zyrat e Publikë, i cili i është nënshtruar kontrollit të kushtetutshmërisë përmes Aktgjykimit të Gjykatës KO216/22 dhe KO220/22, ligj ky që institucioneve të lartcekura, u njeh të drejtën e ushtrimit të funksioneve përkatëse edhe me ligje të veçanta. Sipas sqarimeve të dhëna, një përcaktim i tillë i Ligjit të kontestuar, kushtëzon dhe cenon pavarësinë e institucioneve të pavarura, me theks në dy kategori çështjesh, përkatësisht lidhur me (i) përcaktimin e nivelit të shtesave mbi pagën bazë; dhe (ii) përcaktimin e ekuivalencave.

Në kontekst të çështjes së parë, përkatësisht kushteve dhe tavanëve buxhetore për përcaktimin e shtesave, Aktgjykimi sqaron që sipas Ligjit të kontestuar, lartësia e shtesave, në parim, përcaktohet në vlerën prej zero pikë një për qind (0.1%) deri në zero pikë pesë për qind (0.5%) të fondeve totale të përdorura për pagën bazë të zyrtarëve publikë të organizatës përkatëse buxhetore në të njëjtin vit fiskal, ndërsa për këtë qëllim, Qeveria trajtohet si një (1) organizatë e

